



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2018”.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale””.

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Rakip Suli, Robert Bitri, Rrahman Rraja, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Pjerin Shoshi – Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë

Edlira Llango – Drejtoreshë Juridike në Ministria e Bujqësisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje, kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot në rend dite kemi dy çështje: së pari, miratimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2018”. Ju kujtoj se në seancën e kaluar ne kemi zhvilluar dëgjuesën. Relator i kësaj projektrezolute është zoti Pëllumbi, të cilin e ftoj të bëjë një prezantim të shkurtër të projektrezolutës dhe më pas e hedhim në votim.

Pika tjetër e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale””. Relator i këtij projektligji është zoti Robert Bitri.

Fjala për ju, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Pas analizimit që i bëmë raportit vjetor të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2018, debateve dhe diskutimeve që patëm në mbledhjen e kaluar, dalim me këtë projektrezolutë, që do t’ia paraqesim seancës për aprovim, në lidhje me vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2018.

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke e njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

- duke vlerësuar që fund të vitit 2018, si rezultat i reformës, vihet re një përmirësim i lehtë i gjendjes financiare të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, veçanërisht në drejtim të eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rezultat i aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar, gjë e cila ndikoi edhe në rritjen e numrit të klientëve, rritjes së numrit të ujëmatësve të vendosur, gjë e cila ndikoi në përmirësimin e treguesit të nivelit të matjes, arkëtimeve të debive të prapambetura;

- duke theksuar njëkohësisht se këto arritje nuk përmbushën pritshmëritë e parashikuara nga reforma, sidomos në drejtim të uljes së humbjeve nga eliminimi i lidhjeve të paligjshme;

- duke theksuar se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disavjeçare që po diskutohen, ende nuk janë realizuar;

- duke nxitur qeverinë dhe të gjithë aktorët për të propozuar sa më parë ndryshimet ligjore, të cilat pritet të kenë një impakt pozitiv si në sektorin e ujësjellës –kanalizimeve, ashtu edhe në lidhje me pavarësitë institucionale dhe operacionale të ERRU-s, rolit të saj në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e saktë të kompetencave dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave, rritjen e efektivitetit;

- duke pasur parasysh që reforma territoriale, e ndjekur nga reforma në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve u ka dhënë më shumë përgjegjësi dhe kompetencë bashkive nëpërmjet “Një bashki, një ujësjellës”;

- duke rritur mundësinë e përmirësimit të këtij shërbimi jetik nëpërmjet përdorimit të ekonomisë së shkallës;

- duke pasur parasysh se mungesa e furnizimit të vazhdueshëm dhe tendenca negative e këtij treguesi vijon të mbetet një problem shqetësues, duke ndikuar edhe në cilësinë e ujit;

- duke theksuar se besueshmëria e të dhënave në sektorin e ujësjellës – kanalizimeve vijon të mbetet problematike, duke sjellë në disa raste tregues performance kontradiktore me diferenca të ndjeshme;

- duke theksuar se, me gjithë përpjekjet e bëra, ende nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin, që rregullon dhënien e aktmiratimit të higjienës sanitare, ka marrë në shqyrtim veprimtarinë e Entit Rregullator të Ujit dhe duke vlerësuar përmirësimin e treguesit mbulimi i kostove me 15% , krahasuar me një vit më parë, i cili tregon për përmirësim e aspekteve të menaxhimit nga stafet drejtuese të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve;

- duke vlerësuar rritjen e nivelit të matjes me 5% krahasuar me një vit më parë, përmirësim i cili ka ardhur si rezultat i investimeve në sektor kryesisht nga lidhjet e reja për shkak të riorganizimit;

- duke vlerësuar punën e bërë nga ERRU-ja gjatë vitit 2018 për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të pagesave rregullatore vjetore dhe ato për licencime, që duhet të paguajnë shoqëritë e UK-së;

- duke vlerësuar memorandumin e mirëkuptimit, të firmosur nëpërmjet ERRU-së dhe AK-së për vitin 2018, me qëllim bashkëpunimin ndërmjet tyre për mbrojtjen dhe garantimin e interesave publike ndaj abuzimeve për shërbime monopol, si dhe për krijimin e një mjedisi transparent ligjor në sektorin e ujësjellës –kanalizimeve;

- duke vlerësuar punën e bërë për hartimin e rregullores së re për organizimin e seancës dëgjimore me publikun, e cila rrit seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e seancave dëgjimore me publikun, duke e bërë atë një mjet më efikas dhe komunikues, në funksion të konsumatorit lidhur me problematikat e shërbimeve, si dhe të tarifave që operatori propozon të aplikojë;

- duke vlerësuar rritjen e numrit të ankesave të ardhura në ERRU-së gjatë vitit 2018, 39 ankesa të ardhura kryesisht nga konsumatorët familjarë, numër ky më i lartë krahasuar me vitin 2017, gjë që tregon rritjen e besimit tek ERRU-ja, pavarësisht rolit ndërmjetësues që ERRU-ja ka në dispozitat ligjore në fuqi, kërkon nga ERRU-ja që për vitin 2019 të angazhohet në këto drejtime:

- Në kuadër të reformës të luajë një rol aktiv dhe nxitës, në mënyrë që të bëhet i mundur realizimi i shembujve pilotë i agregimit të disa shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në sektor.

Agregimi i shoqërive do të bënte të mundur përdorimin e ekonomisë së shkallës, me ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e kostove dhe lehtësi në thithjen e fondeve të BE-së për këtë sektor në hapat e mëtejshëm të integritetit të vendit.

Me gjithë tendencën e lehtë rënës të tre vjetëve të fundit të ujit pa të ardhura, ky tregues vijon të mbetet në shifra tepër të larta, ndaj ERRU-ja, nëpërmjet politikave të tarifimit, duhet të ushtojë presion mbi shoqëritë e ujësjellës-kanalizime, duke kërkuar plane veprimi të detajuara, konkrete dhe të matshme, si dhe përmirësimin e këtij treguesi shumë të rëndësishëm.

ERRU-ja duhet të kërkojë argumentim të plotë dhe të saktë për numrin e punonjësve dhe përshkrimin e detajuar të punës për secilin pozicion të stafit të saj dhe, njëkohësisht, të nxisë një përdorim më të madh të teknologjisë në sektorin e ujësjellës-kanalizime, në mënyrë të veçantë, për të bërë të mundur uljen e ngarkesës artificiale me staf për shërbime roje, gjë e cila ndikon në rritjen e eficiencës së stafit, i cili, me gjithë përmirësimin e lehtë, është një tregues që vijon të mbetet i lartë.

Duke qenë se saktësia e të dhënave vijon të mbetet një problem në përllogaritjen e treguesve të performancës, si dhe në hartimin e balanceve të sakta të ujit në bazën të planeve pesëvjeçare të biznesit të shoqërive Ujësjellës Kanalizime, ERU nga njëra anë të nxitë shoqëritë që të marrin masa për instalimin e matësve në burim dhe nga ana tjetër të bashkëpunojë me ministrinë dhe AK-në për implementimin e planit të punës për pajisjen e të gjitha shoqërive me ujëmatës të mëdhenj.

Meqenëse edhe në vitin 2018 norma e arkëtimit vijon të mbetet e njëjtë me atë të një viti më parë, pas rënies së ndjeshme që pati në vitin 2016, ERU përmes të gjithë instrumentave ligjorë që disponon duhet të kërkojë nga të gjitha shoqëritë Ujësjiellës-Kanalizime rritjen e këtij treguesi, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive.

Në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve për garantimin e një zgjidhje sa më të drejtë dhe efikase të ankesave të konsumatorëve, të miratojë rregulloren për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, e cila ishte e përfshirë edhe në objektivat dhe rekomandimet e vitit 2018.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij sektori, si dhe të drejtën e çdo qytetari për të pasur shërbim në furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, ERU në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit do të ketë gjithmonë në konsideratë faktorin e përballueshmërisë për aprovimin e tarifave.

Të rrisë përpjekjet për promovimin e institucionit përmes mjeteve të informimit publik, si dhe mediave sociale për të bërë të mundur ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre dhe rolin e ERU-së për mbrojtjen e interesave të konsumatorit.

ERU të vlerësojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri rekomandimet e bëra nga institucionet e tjera lidhur me vendimmarrjen e saj apo me sektorin e ujësjiellës kanalizimeve, në mënyrë të veçantë nga Autoriteti i Konkurrencës, me të cilin ka edhe një memorandum mirëkuptimi.

Të finalizojë dhe të miratojë sa më parë metodologjinë e vendosjes së tarifave, duke iu referuar edhe eksperiencave më të mira ndërkombëtare nga konsultimi me shoqatën Rregullatore të Europës. Kjo metodologji ishte e përfshirë në objektivat dhe rekomandimet edhe në vitin 2018.

Të marrë pjesë aktive me propozime konkrete. Të bashkëpunojë ngushtësisht me Ministrinë e Energjisë dhe aktorët e tjerë për hartimin e ndryshimeve ligjore, të cilat, megjithëse të vonuara, pritet të sjellin një përcaktim më të qartë të statusit ligjor të ERU-së, si dhe një dimension të ri lidhur me rolin si institucion i pavarur në sektorin e Ujësjiellës Kanalizime.

Kjo është rezoluta.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Fjalën e ka zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Unë mendoj që në pjesën e tretë paragrafët që fillojnë “duke qenë se” i takojnë grupit të dytë. Në grupin e dytë është marrë në shqyrtim veprimtaria e Entit

Rregullator të Ujit, pra kemi marrë në shqyrtim dhe themi: “1, 2, 3, 4, 5 dhe 6”. Në paragrafin ku themi “duke qenë se saktësia e të dhënave” edhe kur themi “duke qenë norma e arkëtimit”, edhe kur themi “duke pasur parasysh” mendoj se vjen nga vlerësimi që kemi bërë, prandaj pjesa e parë e këtyre tre paragrafëve duhet të jetë te grupi i dytë i rezolutës. Te grupi i dytë ku kemi marrë në shqyrtim nuk eidentojmë vetëm gjërat pozitive, por vlerësojmë diçka më mirë apo më keq. Ne nuk mund t’i kërkojmë Entit dhe të fillojmë me “duke qenë se”, sepse i kemi bërë në pjesën e dytë, mendoj unë, si çështje e logjikës së arsytimit. Ne vlerësojmë dhe pastaj dalim me rekomandime.

Niko Peleshi – Cilat pika janë konkretisht? Pikat “duke qenë se saktësia e të dhënave... e të tjera”

Ilir Beqja – “Duke qenë norma e arkëtimit”, “duke pasur parasysh”, pra gjysma e parë e këtyre paragrafëve duhet të kalojë në pjesën e dytë të projektrezolutës dhe ajo çfarë duhet të bëjmë duhet të ngelet te pjesa e tretë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pavarësisht, t’i përsëri i vlerëson.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne themi këtu “duke qenë se saktësia e të dhënave” dhe pastaj themi “vazhdo detyrën”, nëse detyra nuk është bërë, atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe diçka tjetër, nuk më ngjit nga ana juridike dhe ekonomike termi “agregimi i shoqërive”, të pyesim nëse mos kanë ndonjë term më të qartë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – “Agregimi” përdoret si term.

Ilir Beqaj – Është term zhargon, të shohim për ndonjë term tjetër juridik

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur bashkohen shoqëritë tregtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të sugjeroja që entet që përdoren vetëm një herë të mos jenë me akronime. Ne mund ta lëmë ERU, sepse është e sektorit, edhe UK mund ta lëmë kështu, ndërsa Autoriteti i Konkurrencës nuk mund të lihet AK, sepse është institucion që përmendet vetëm një herë dhe jo të gjithë ata që lexojnë rezolutën e dinë që është fjala për Autoritetin e Konkurrencës. Termat e tjerë që janë akronime të ligjit dhe të kësaj teme mund t’i lëmë ashtu.

Këtu ku themi: “uljen e ngarkesës artificiale me staf për shërbimin e rojeve”, duke qenë smirëshërbimin, ujësjellësi e blen si shërbim dhe nuk e di se çfarë stafi ka...

(Diskutime pa mikrofon)

E kuptoj, por të zëvendësojë shërbimin e rojës me CCTV.

E para, duhet të ketë më shumë kushte dhe fjala “staf” nuk ka pse të jetë, por të jetë “shërbim rojë fizike me CCTV”, pasi ky është një shërbim që t’i e kontraktton. Pra, nuk thuhet që ujësjellësi do të marrë 5 roje, pasi shërbimi i rojeve është një numër i caktuar dhe këtë më mirë e di ai që e ofron këtë shërbim. Unë mendoj se duhet bërë balanca midis shërbimit të sigurisë fizike dhe CCTV-së dhe mendoj se fjala “staf” nuk vlen...

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon termit “higjiena” akti i miratimit mendoj se duhet të ketë ndonjë gabim ortografik, është në fund të faqes së parë.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull.

Niko Peleshi – Ku është kjo, Ilir?

Ilir Beqaj – Kjo është thjesht çështje gjuhësore dhe mund ta zgjidhin ata që e zbardhin, nuk është ndonjë gjë.

Niko Peleshi - Hedhim në votë rezolutën, sipas propozimit të zotit Beqaj, dhe në qoftë se bie, do të vazhdojmë me propozimet e tjera.

Propozimi i zotit Beqaj, më korrigjoni në qoftë se harroj ndonjë gjë, është që te pikat e pjesës së tretë të rezolutës, praktikisht janë paragrafët 3, 4 dhe 6. Konkretisht në paragrafin 3, thuhet: “Duke qenë se qartësia e të dhënave vijon të mbetet...”. Në paragrafin 4, thuhet: “Duke qenë se norma e arkëtimit në vitin 2018 vijon të mbetet...”, ndërsa në paragrafin 6, thuhet: “Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndershmërinë...”, gjysma e parë e fjalisë të kalojë te pjesa e dytë e rezolutës dhe te ky paragraf të mbetet vetëm fjalia, duke filluar nga: “ERU nga njëra anë të nxisë shoqëritë UK që të marrin masa për instalimin e matësve në burim dhe nga ana tjetër të bashkëpunojë me...”. Kjo është pika 3.

Sa i takon pikës 4, të hiqet pjesa e parë ku thuhet “duke qenë se norma” dhe të shkojë te blloku i dytë e rezolutës dhe këtu të ngelet paragrafi që fillon: “ERU përmes të gjitha instrumenteve ligjorë që disponon të kërkojë nga Shoqëritë e Ujësjellës-Kanalizimeve rritjen e këtij treguesi, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive UK”.

Në paragrafin 6 të bllokut të tretë, pra këtu ku jemi, që fillon “duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndershmërinë” gjysma e fjalisë të shkojë te blloku i dytë i rezolutës dhe ky paragraf të fillojë “ERU të ketë gjithmonë në konsideratë faktorin e përballueshmërisë për aprovimin e tarifave”, pasi riformulimi gjuhësor do të shihet nga shërbimi. Kjo është një

pjesë e propozimit, ndërsa pjesa tjetër është për fjalën “agregim”, në qoftë se nuk gjendet në legjislacionin për shoqëritë tregtare për t’u zëvendësuar me terminologjinë e duhur të ngelet ashtu siç është.

Sa i takon pikës 3, të mos përdoret akronimi AK (Autoriteti i Konkurrencës), por të përdoret e plotë dhe të korrektohet “shërbimi i rojeve fizike me CCTV” dhe jo “stafi”. Pra fjala “stafi” të hiqet.

Ky është propozimi që bëhet. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Eglantina Gjermeni – Kisha vetëm një sugjerim lidhur me raportimin e institucioneve të pavarura në Kuvendin e Shqipërisë. Ne vërtetë u kemi lënë këto detyra institucioneve, por duke qenë se disa prej këtyre detyrave kanë qenë edhe në vitin 2018 dhe nuk janë realizuar mendoj të kemi një raportim të paktën 3-mujor ose 6-mujor dhe jo 1 herë në vit në mënyrë që të monitorojmë më mirë ecurinë e angazhimeve që ata kanë marrë...

Niko Peleshi – Kjo është pikë e rezolutës?

Eglantina Gjermeni – Mendoj se duhet të shtohet dhe të raportojnë...

Marlind Myftiu – Është një vendim i Kuvendit, i cili është miratuar vjet në dhjetor që i detyron të gjithë institucionet e pavarura që çdo 4 muaj të raportojnë...

Niko Peleshi – Paska një vendim të Kuvendit ku çdo 4 muaj institucionet duhet të vijjnë të raportojnë, kështu që ne kemi të drejtën të kërkojmë zbatimin e atij vendimi.

Hedhim në votim variantin e rezolutës të ndryshuar, sipas propozimit të zotit Beqaj. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet rezoluta me ndryshimet, sipas propozimit të zotit Beqaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë më, 18.03.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale””

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Besnik Baraj, Dritan Bici, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Rakip Suli, Robert Bitri, Rrahman Rraja, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Pjerin Shoshi – Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë

Edlira Llango – Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Bujqësisë

Niko Peleshi - Kalojmë në pikën e dytë të axhendës së sotme, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale””. Relator i këtij projektligji është zoti Robert Bitri, i cili do të na bëjë një prezantim të shkurtër nëse e çmon, përndryshe fjalën do t’ia jap përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural.

Zoti Pjerin dhe zonja Edlira, faleminderit që keni ardhur!

Edhe pse u njoftuat për të ardhur shpejt, unë e dija që ju nuk do të na e prishnit.

Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Ky projektligj është ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik në vitin 2017. Vlera e këtij projekti është rreth 2 milionë euro dhe kontrata ka përcaktuar afate që deri në 31 dhjetor të vitit 2021 duhet të lidhen të gjitha marrëveshjet ndërmjet të dy qeverive, në të kundërt, e gjithë vlera që është pa lidhur, automatikisht nuk bëhet e vlefshme për t’u përdorur nga qeveria shqiptare.

Në bazë të marrëveshjes që ne kemi të firmosur nga Ministria e Bujqësisë dhe nga qeveria gjermane unë kam disa pyetje. A ka fusha të përcaktuara saktësisht ku do të përdoren këto fonde?

Së dyti, lexova të marrëveshja që rimbursimi i qeverisë shqiptare për disa veprime do të bëhet nëpërmjet taksimit, atëherë sa shkon vlera totale e këtij projekti?

Pjerin Shoshi- Faleminderit!

Projekti prej 2 milionë eurosh nga qeveria gjermane konsiston në vazhdimin e projektit të mëparshëm që GIZ ka mbështetur qeverinë shqiptare nëpërmjet projektit SARED.

Duke qenë se tashmë Ministria e Bujqësisë ka filluar të implementojë projektin IPARD, ky projekt është bazuar më së shumti nëpërmjet asistencës teknike dhe rritjes së kapaciteteve, për Ministrinë e Bujqësisë dhe institucioneve në varësi të saj.

4 fushat kryesore ku ky si projekt bazohet janë: hartimi i politikave dhe strategjive që do të përmirësojnë punën e Ministrisë së Bujqësisë; promovimi dhe fuqizimi i zinxhirit të vlerës; rritja e kapaciteteve stafit të Ministrisë së Bujqësisë dhe institucioneve të kësaj ministrie dhe institucioneve të tjera që bashkëpunojnë me Ministrinë e Bujqësisë, pra edukimet, trajnimet dhe, e fundit, masat për zhvillimin rural.

Sa i përket rimbursimit të TVSH-së, pritet që rritja të jetë rreth 200 mijë euro.

Niko Peleshi - A ka pyetje?

Gazmend Bici - Desha të sqarohesha në lidhje me historikun e kësaj marrëveshjeje, sepse këtu është data 21 tetor 1988 dhe termat janë të asaj kohe. A mos është viti gabim?

Edlira Llango – Marrëveshja e vitit 1988 është një marrëveshje kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ku nga palët, sidomos nga qeveria e Gjermanisë shprehet vullneti për të ndihmuar Republikën e Shqipërisë në fusha të ndryshme.

Gazmend Bici – Do të thotë që edhe atëherë qenkan nënshkruar marrëveshje, sepse thuhej që para viteve '90 nuk lejoheshin..

Shqipërisë në atë kohë i është dhënë mundësi, por nuk e ka shfrytëzuar. Tani po shohim se qenka nënshkruar një marrëveshje, ndaj pyeta për historikun. 2 milionë euro janë jashtëzakonisht të mëdha për asistencë teknike. Dihet që Gjermania nuk mund të na japë mendim për zonat rurale, sepse dihet që ajo ka kaluar që në shekullin XVII stadin ku ne jemi sot.

Niko Peleshi – Ka edhe grante, apo jo, Pjerin?

Pjerin Shoshi- E gjithë shuma është në formën e grantit.

Edlira Llango -Para disa muajsh u miratua në Kuvend projektligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vlerën 5 milionë euro. Tani ky grant 2 milionë euro është për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Në dijeninë time unë kam këtë historik, për të tjerat mund të interesohem më tej.

Pjerin Shoshi- Sa i përket rritjes së kapaciteteve, asistencë teknike, qeveria shqiptare e lancuar projektin IPARD 2, i cili do të trajtojë në vazhdimësi stafin e Agjencisë së Pagesave AZHBR, në implementimin sa më me sukses, për herë të parë, të këtij projekti. Ndërkohë projekti IPARD I, ka qenë paraardhësi i IPARD II-it, është implementuar nga GIZ-i dhe nga projekti “SARET“, që është paraardhësi i këtij projekti që ne kemi sjellë sot për miratim, sepse në atë kohë Agjencia e Pagesave nuk kishte kapacitetin e mjaftueshëm në burime njerëzore, por edhe në infrastrukturë për implementimin me sukses me standardet e IPARD-it. Pra, trajnimet do të synojnë përmirësimin e kapaciteteve të stafit.

Niko Peleshi - Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit për prezantimin!

Së pari, doja të falënderoja qeverinë gjermane për ndihmën dhe bashkëpunimin! Marrëveshja që lidhet me zhvillimin e qëndrueshëm përkon edhe me objektivat që qeveria

shqiptare ka ratifikuar, por kisha nevojë për një informacion lidhur me zbatimin e projektit apo të marrëveshjes më parë.

Ju thatë se më parë keni pasur një marrëveshje tjetër me qeverinë gjermane, apo jo? Edhe ne kemi kaluar marrëveshje për ndihmën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe, duke qenë se kjo është një çështje që do ta diskutojmë edhe në seancë plenare, do të doja të na ndihmonit me një informacion lidhur me ecurinë para se të ratifikohet kjo marrëveshje e dytë që po vjen, e bashkëpunimit gjerman. Ku ka ndihmuar dhe ku ka konsistuar kjo ndihmë në zhvillimin rural apo në zhvillimin e bujqësisë në tërësi?

Pyetja tjetër lidhet me marrëveshjen që do të miratojmë sot. Ju thatë se është asistencë teknike për ju, për Ministrinë e Bujqësisë dhe për AZHBR-në në përgjithësi. Nuk ka asnjë komponent granti apo dhënie ndihme? 2 milionë euro është vetëm asistencë teknike? Puna është se ne nuk i kemi më drejtoritë e bujqësisë, kë do të ndihmojmë në këtë rast me këtë marrëveshje përveç Ministrisë së Bujqësisë dhe AZHBR-së?

Faleminderit!

Pjerin Shoshi - Faleminderit, zonja deputete!

Marrëveshja që kaloi në parlament para disa muajsh me KfW-në kishte lidhje me një fond garancie, e cila u mundësonte bankave të ulnin kolateralin dhe kërkesat, pra të ishin më të dëshiruara për të dhënë kredi për sektorin e agro-biznesit, më së shumti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Për sa i përket projektit paraardhës, dhe momenti që jemi tani është vazhdimi i tij, projekti disavjeçar “SARET” ka përfunduar në fund të vitit 2018, i cili konsistonte në një skemë grantesh (vlerën e të cilëve dhe një raport për ecurinë e granteve do t’jua dërgoj) gjithashtu, ka qenë i përqendruar në asistencën teknike njësoj si projekti i mëparshëm, duke qenë se sot grantet nga Ministria e Bujqësisë jepen në dy forma kryesore që janë: skema kombëtare e mbështetjes nga paratë e buxhetit të shtetit dhe nga projekti “IPARD II”, i cili është përqendruar më së shumti në asistencën teknike. Është e vërtetë që drejtoritë e bujqësisë nuk ekzistojnë më, por nuk është se këto institucione janë shuar, sepse këto janë ndarë në dy forma tipologjie të reja agjencish. Janë krijuar 4 agjenci të reja të ekstensionit bujqësor, ose me fjalë të thjeshta “të shërbimit të këshillimit” dhe 4 agjenci të tjera rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve. Pra do të jenë këto,

së bashku me AZHBR-në, por dhe me disa institucione të tjera të varësisë, plus stafi i drejtpërdrejtë i ministrisë, të cilat do të përfitojnë nga kjo asistencë teknike.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Ka pyetje? Nuk ka.

Faleminderit për përgjigjet dhe prezantimin!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2017 për projektin “Projekti për zhvillim të qëndrueshëm të zonave rurale””. Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen të këtij projektligji.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë në tërësi projektligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Faleminderit!

Nesër kemi një seancë tjetër për një marrëveshje për energjinë. Në qoftë se nuk ka kundërshtim, e lëmë për në orën 10.00, sepse të dyja këto marrëveshje do të kalojnë për miratim në seancën plenare të ditës së enjte, ndaj edhe u ngutëm pak.

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA